

Diskutim i hapur në lidhje me ndërtimin e xhamisë në Wil

Në një atmosferë të hapur dhe në një sallë të bukur u zhvillua një diskutim i hapur në lidhje me ndërtimin e xhamisë në Wil. Organizatorët, pra Xhamia Wil, ftoi në skenën për prezentim mendimesh dhe përgjigje pyetjeve të publikut persona nga sfera të ndryshme.

Xhaminë e përfaqësoi Dr. Hisham Maizar me cilësinë e tij si udhëheqës i projektit dhe z. Safet Abdullahi me cilësinë e tij si arkitekt.



Pamje nga podiumi

Përfaqësuesi i komunës ishte z. Makus Zunzer, i cili drejton entin e ndërtimtarisë së lartë dhe thellë, kurse nga politikanët merrnin pjesë z. Patrik Bernold, kryetari i CVP (Partisë Kristiano-Popullore, njëherit edhe në pushtet), z. Dario Sulzer, deputet i SP (Partisë Social-Demokrate) në Parlamentin e Wil-it, z. Mario Schmitt, deputet i SVP (Partisë Popullore Zvicrane), njëherit edhe lancuesit e referendumit për ndalimin e minareve; sidhe z. Jigme Shitsetsang, kryetari i FDP (Partisë Liberale).



Këtë tribunë e zbukuruan krahas dy priftërinjëve të qytetit, z. Roman Giger, prift i kishes katolike dhe kolegut të tij protestant, z. Christoph Casty, edhe autoriteteve tjerë të qytetit dhe më gjërë.

Z. Hanspeter Spörri udhëheqi këtë debat mjaft të rëndësishëm në formën e tij më të njohur nga ai, bukur profesionale.

Përderisa fjalën përshëndetëse e mori Abdullah Mustafa, kryetari i qendrës Islame në Wil dhe i përshëndeti dhe i falenderoi të pranueshmit për prezencë masovike, arkitekti përgadiste anën teknike për prezentimin e qendrës.

Në formë tejet transparente dhe të deteluar, prezantoi arkitekti në fjalë fotografitë dhe skicat e qendrës Islame që synohet të ndërtohet.

Një qetësi absolute mbizotëroi në publik. Shenjat e mahnisë nga bukuria e qendrës së re, shiheshte edhe në fytyrat e publikut, e numri i tyre kishte bërë që asnjë karrige nga 300 të shtruarat në sallë, mos të mbetet bosh. Ky publik përbëheshte nga të rrij e të rreja, vendas dhe të huaj, nga musliman dhe jomusliman.



Pamje nga publiku

Pas prezentimit të objektit dhe sqarimeve të duhura, e merr fjalën Dr. Hisham Maizar, i cili edhe ashtu ishte i mjaftpritur nga publiku. Ai tërhoqi një paralele nga historia midis muslimanëve dhe jomuslimanëve. Ai prezantoi strategjinë e informimit transparent të xhamisë dhe prezantoi datat e thuktë, se në cilën ditë me cilin grup njerëz nga qyteti, fqinjët dhe organet kishtarë ishin tubuar, për t'u sqaruar atyre në lidhje me planin tonë.

Këtë ndjenjë të qetësisë së dëgjimit e prishi ataki i deputetit të partisë popullore Zvicrane (SVP), z. Schmitt, i cili kërkoi nga moderatori të mos e ndërpreje deri sa të thotë atë që dëshiron. Ai atakoi ashpër social-demokratët, të cilët në shkrimin e djeshëm të Gazetës Wiler Zeitung (Gazeta e Wilit), kishin akuzuar atë dhe partinë e tij që përmes fqinjëve të xhamisë dhe përmes ndërtimit të xhamisë po zhvillon fushatë parazgjedhore.


Sulmi i tij nuk filloi dhe përfundoi në politik, por ai vazhdoi edhe në Islam. Ai sulmoi bashkëbiseduesin e tij në podium Dr. Hisham Maizar-in për tentativë për futjen e shariatit në

ligjin Zvicran dhe xhaminë në Wil si qender jo e integruar në strukturat Zvicrane, ngase kjo e dyta, parasheh ndarjen e grave dhe burave ne faltore.

Po mos të reagonte një zonjë nga publiku te moderatori, me siguri se zotëriu në fjalë do të kishte edhe më shumë akuza dhe për më shumë persona.

Z. Dario Sulzer, i moshës së tredhjetëve, dhe deputet i shkathhtë tek social-demokratët, e pyeti parafolësin e tij, se si zhvillohen lutjet në kishë dhe pse kemi edhe ne në Wil një shkollë krishtare të nivelit sekundarë që është e veçuar për vajza. Aty nuk ka të drejtë të mësojnë djem. A duhet edhe këtë shkollë Zvicrane t`a kategorizojmë të paintegruar.

Fjala e z. Patrik Bernold nga partia kristiano-popullore (CVP), paraqiti mbështetjen e plotë të tij për projektin dhe muslimanët. Kësaj mbështetje të fuqishme iu bashkangjitën edhe dy priftërinjtë në podium. Përderisa ai katolik paraqiti bashkpunimin e mirë me muslimanët dhe me imamin, mr. Bekim Alimi-n, dhe se kjo ishte një mundësi e mirë për zhvillimin e dialogut, dhe ia bëri me dije publikut thëniet e njohura të teologut Hans King, se nuk do të ketë paqë ndërnacionale deri sa nuk ka paqë fetare dhe nuk ka paqë fetare derisa nuk do të ketë dialog ndërfetare, prezentohet prifti protestant dhe vërteton këtë lloj bashkpunim të ndërsjelltë duke e pa të rrugës se muslimanët meritojnë të ndërtojnë qendrën e tyre, ashtu sikur iu konvenon atyre. Ai lexoi edhe disa reshta nga një libër i shkruar në vitin 1890, kur për herë të parë ishte themeluar kisha e tij protestante në Wil dhe si edhe ata në atë botë kanë pësuar në vështirësi edhe më të mëdha se sot muslimanët. Me fjalinë e tij, ka kaluar koha e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe se apeloj sa më shpejt të niset puna në këtë drejtim.




Nuk munguan as pyetjet e shumta nga publiku. Një person i cili banon në këtë lagje, pra afër vendit ku duhet ndërtuar xhamia, u prezentua dhe tha se ai nuk ka gjë kundër xhamisë, por problemi i tij është qarkullimi i shumtë i veturave dhe parkingu i pakët në këtë zonë sidhe në xhami. Edhe pse xhamia ka paraparë një parking nëntokësorë dhe në përgjithsi posedon një numër prej 52 parkingje, kjo disi nuk plotëson numrin e kërkuar nga reaguesit.

Kësaj pyetje i përgjigjet z. Markus Zunzer, nga departamenti i ndërtimit pranë komunës së Wil-it, i cili thot se për raste specifike apo manifestime më të mëdha të xhamisë, ne

posedojmë në afërsi prej 100 metrave vend parking me kapacitet mbi 1000 vetura, pra kjo mund të jetë edhe një zgjidhje e mirë.

Këtyre të rreshurave të pyetjeve iu bashkangjitet edhe një rinist nga xhamia i cili në formë skeptike, se si nuk do të mjaftojnë 52 vendparkinge, përderisa sot, në qendrën momentale i kemi 3 parkinge dhe nuk kemi ndonjë problem të madh në këtë kontekst?

Shumë i pritur nga masa ishte edhe prezentimi i imamit të xhamisë. Ai iu drejtua publikut por edhe përfaqësuesit të partisë SVP, z. Schmitt, duke thënë:



- Që imamit sot para jush nuk i duhet përkthyes, kjo nuk është rastësi
- Që imami ynë së paku gjysmën e publikut e njih personalisht, edhe kjo nuk është rastësi
- Që imami ynë hutbet e së premtes që nga viti 2004 i mban edhe në gjermanisht, kjo nuk është rastësi
- Që ne në këtë objekt pas referendumit të minares në Zvicër, nuk kemi parapar minare nuk është rastësi
- Që ne kemi organizuar vend për mysafirët në xhaminë e re, nuk është rastësi
- Që xhamia në Wil që nga viti 2001 ka pranuar 282 grupe vizitorësh, mendoni se është rastësi?

Jo, këta nuk janë rastësi që ndoshin, por angazhim i kësaj qendre islame. Pra lus përfaqësuesin e partisë popullore Zvicrane, këtë akuzë për dezintegrim t'a dërgoje ku të do, por jo në Wil, kështu mr. Bekim Alimi, imami i xhamisë.

Këto edhe shumë pyetje tjera u diskutuan haptas në publik. Njerzit u ndanë pas një qind minutave angazhim. Përderisa ana muslimane dhe shumica absolute e partive politike u ndanë të kënaqur, ankuesit dhe disa persona të caktuar mbeten jo edhe aq dakord.

Së fundi, kjo ishte një mbrëmje në të cilën njerzit panë qendrën e re Islame, biseduan dhe më gjatë mes veti dhe u larguan përmes treqarëve të mbuluar mirë me borën e shkurtit të vitit 2012.

Me shpresë që në shkurtin e ardhshëm të mund të ftojme këta njerëz në qendrën e re, përfundojmë këtë përshkrim.

Wil, shkurt 2012

Mr. Bekim Alimi